Blv. Zhan d'Ark , nr. 3
Tiranë, 1001
Tel: +355 4 2222 411
Faks: +355 4 2228300

info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

# Treguesit demografikë

## Tremujori 4 - 2017

**Tiranë, më 14 Shkurt 2018:** Numri i lindjeve për tremujorin e katërt 2017, rezulton 7.931, duke shënuar një rënie me 2,3 %, në krahasim me tremujorin e katërt 2016. Gjatë vitit 2017, kanë lindur 30.869 foshnje, duke shënuar një rënie me 2,7 %, krahasuar me një vit më parë.

Numri i vdekjeve për tremujorin e katërt 2017 rezulton 5.408, duke shënuar një rënie prej 6,9 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016. Numri i vdekjeve në vitin 2017, është 22.232 persona, duke shënuar një rritje me 3,9 %, krahasuar me një vit më parë.

Shtesa natyrore e popullsisë në tremujorin e katërt 2017 është 2.523 dhe rezulton me rënie 8,0 %, në krahasim me tremujorin e katërt 2016. Ky tregues për vitin 2017 është 8.637 dhe rezulton me rënie 16,5 % krahasuar me një vit më parë.

### Fig. 1 Shtesa natyrore e popullsisë




Në tremujorin e katërt 2017, shtesa natyrore e popullsisë për 12 qarqet e Shqipërisë, shënon vlerën më të lartë në qarkun e Tiranës, ku numri i lindjeve tejkalon me 1.191 numrin e vdekjeve. Me shtesë natyrore të lartë paraqitet qarku i Durrësit me 375 lindje më shumë se vdekje, pasuar nga qarku i Dibrës me 257 lindje më shumë se vdekje.

**Për publikim 14/02/2018**

*Vijon*

Shtesa natyrore e popullsisë, në tremujorin e katërt 2017, regjistron vlerë negative vetëm në dy qarqe (Gjirokastër dhe Korçë). Vlera më e ulët shënohet në qarkun e Gjirokastrës, ku numri i vdekjeve tejkalon me 41 numrin e lindjeve.

**Fig. 2 Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarqeve, T4 – 2017**




**Lindjet**

Numri më i ulët i lindjeve për tremujorin e katërt 2017 regjistrohet në qarkun e Gjirokastrës, 158 lindje, me një rënie prej 6,0 %, në krahasim me tremujorin e katërt 2016. Numri më i madh i lindjeve regjistrohet në qarkun e Tiranës me 2.529 lindje, të cilat shënojnë rritje me 2,8 % në krahasim me tremujorin e katërt 2016.

Shtatë qarqe pësuan rënie të numrit të lindjeve në tremujorin e katërt 2017, krahasuar me tremujorin e katërt 2016. Rënien më të madhe të numrit të lindjeve gjatë kësaj periudhe e shënon qarku i Elbasanit me 15,0 % dhe qarku i Beratit me 13,7 %.

**Tab. 1 Lindjet sipas qarqeve**

| | Qarqet | 2016 | 2017 | Ndryshimi vjetor në % | T4 - 2016 | T 4 - 2017 | Ndryshimi tremujor në % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Shqipëria** | **31.733** | **30.869** | **-2,7** | **8.119** | **7.931** | **-2,3** |
| 1 | Berat | 1413 | 1319 | -6,7 | 380 | 328 | -13,7 |
| 2 | Dibër | 1787 | 1715 | -4,0 | 431 | 443 | 2,8 |
| 3 | Durrës | 3260 | 3270 | 0,3 | 833 | 857 | 2,9 |
| 4 | Elbasan | 3287 | 2996 | -8,9 | 871 | 740 | -15,0 |
| 5 | Fier | 3202 | 3015 | -5,8 | 851 | 781 | -8,2 |
| 6 | Gjirokastër | 647 | 566 | -12,5 | 168 | 158 | -6,0 |
| 7 | Korçë | 2060 | 1956 | -5,0 | 481 | 499 | 3,7 |
| 8 | Kukës | 1141 | 1091 | -4,4 | 262 | 255 | -2,7 |
| 9 | Lezhë | 1576 | 1501 | -4,8 | 407 | 406 | -0,2 |
| 10 | Shkodër | 2073 | 2043 | -1,4 | 535 | 483 | -9,7 |
| 11 | Tiranë | 9.510 | 9.680 | 1,8 | 2.459 | 2.529 | 2,8 |
| 12 | Vlorë | 1656 | 1586 | -4,2 | 414 | 423 | 2,2 |
| | *Të panjohur* | 121 | 131 | | 27 | 29 | |

** Kategoria '**Të panjohur**' nënkupton numrin e lindjeve të gjalla për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar lindja, mungon.*

## Vdekjet

Numri më i lartë i vdekjeve për tremujorin e katërt 2017 regjistrohet në qarkun e Tiranës, me 1.338 vdekje, me një rënie prej 7,5 %, në krahasim me tremujorin e katërt 2016. Numri më i ulët i vdekjeve regjistrohet në qarkun e Kukësit, me 142 vdekje, me një rritje prej 0,7 %, në krahasim me tremujorin e katërt 2016.

Rënia më e madhe e numrit të vdekjeve në krahasim me tremujorin e katërt 2016, është regjistruar në qarkun e Dibrës me 41,9 %. Në tremujorin e katërt 2017, gjithashtu, me rënie të numrit të vdekjeve paraqitet qarku i Beratit me 15,9 %, qarku i Durrësit me 8,3 % dhe qarku i Fierit me 8,1 % krahasuar me tremujorin e katërt 2016.

## Tab. 2 Vdekjet sipas qarqeve

| | Qarqet | 2016 | 2017 | Ndryshimi vjetor në % | T4 - 2016 | T 4 - 2017 | Ndryshimi tremujor në % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Shqipëria** | **21.388** | **22.232** | **3,9** | **5.782** | **5.408** | **-6,9** |
| 1 | Berat | 1.168 | 1.223 | 4,7 | 320 | 276 | -15,9 |
| 2 | Dibër | 937 | 920 | -1,8 | 264 | 186 | -41,9 |
| 3 | Durrës | 1.936 | 1.955 | 1,0 | 522 | 482 | -8,3 |
| 4 | Elbasan | 2.077 | 2.206 | 6,2 | 524 | 549 | 4,6 |
| 5 | Fier | 2.313 | 2.500 | 8,1 | 652 | 603 | -8,1 |
| 6 | Gjirokastër | 809 | 821 | 1,5 | 207 | 199 | -4,0 |
| 7 | Korçë | 2.140 | 2.197 | 2,7 | 559 | 528 | -5,9 |
| 8 | Kukës | 512 | 610 | 19,1 | 141 | 142 | 0,7 |
| 9 | Lezhë | 998 | 1.018 | 2,0 | 255 | 244 | -4,5 |
| 10 | Shkodër | 1.823 | 1.875 | 2,9 | 482 | 454 | -6,2 |
| 11 | Tiranë | 5.095 | 5.249 | 3,0 | 1.438 | 1.338 | -7,5 |
| 12 | Vlorë | 1.560 | 1.633 | 4,7 | 412 | 404 | -2,0 |
| | *****_Të panjohur_ | 20 | 25 | | 6 | 3 | |

** Kategoria **'Të panjohur'** nënkupton numrin e vdekjeve për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar vdekja nuk është i njohur.*

# Shënime metodologjike

## 1. Lindjet

*Të dhënat e lindjeve*

Të dhënat e lindjeve sipas gjinisë sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve) edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

*Regjistrimet e vona të lindjeve*

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i lindjeve të regjistruara vonë në vitin e mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

## 2. Vdekjet

*Të dhënat e vdekjeve*

Të dhënat e vdekjeve sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile sipas karakteristikave bazë demografike. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve) edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

*Regjistrimet e vona të vdekjeve*

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i vdekjeve të regjistruara vonë në vitin e mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

**Përkufizime:**

**Shtesa natyrore e popullsisë:** Shpreh rritjen / rënien e popullsisë si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj gjatë një periudhe kohë. Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

**Lindje e gjallë:** Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete.

**Vdekje***:* Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksionevevitale pa aftësinë e ringjalljes).

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.